



Në bazë të nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve të projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-775/1 të datës 26.01.2026 dhe në lidhje me Programin për aktivitete në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtar i zyrtarë i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25, dhe 3/26), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit "Festivali i verës - Vinoskop"

1. LËNDA

1.1. Lënda e Thirrjes publike është ndarja e burimeve financiare për realizimin e manifestimit "**Festivali i Verës - Vinoskop**" me qëllim zhvillimin, promovimin, mbështetjen dhe avancimin e turizmit, hotelerisë dhe tregtisë me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetin e Shkupit.

2. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

2.1. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha shoqatat e qytetarëve, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare dhe agjencitë e marketingut, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe Ligjin për shoqëri tregtare.

3. Korniza kohore dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve

3.1. Mjetet financiare për realizimin e manifestimit "Festivali i Verës - Vinoskop" janë siguruar nga Buxheti i qytetit të Shkupit për vitin 2026.

3.2. Përdorimi i mjeteve të ndara financiare do të rregullohet me marrëveshje të lidhur midis Qytetit të Shkupit dhe aplikuesit i cili i plotëson kushtet në përputhje me Thirrjen publike dhe kriteret për zgjedhjen e propozim - projektit në përputhje me Rregulloren për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve të projektit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

4. Kushtet themelore

4.1. Kushtet themelore që duhet të plotësojnë aplikantët e interesuar që marrin pjesë në këtë thirrje publike janë:

- Të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup;
- Të kenë shlyer detyrimet ndaj qytetit të Shkupit (tatimi, taksa komunale); dhe
- Të mos kenë ndalim për pjesëmarrje në procedura të thirrjeve publike, dhënien e kontratave për furnizim publik dhe kontrata për partneritet publiko-private.

5. Kriteret e veçanta dhe mënyra e vlerësimit me pika për përzgjedhjen e aplikantëve

5.1. Kriteret e veçanta dhe mënyra e vlerësimit me pika për përzgjedhjen e aplikantëve janë parashikuar në Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-775/1 të datës 26.01.2026, e cila është botuar në faqen e internetit të qytetit të Shkupit.

6. Dokumentacioni i kërkuar që aplikanti duhet ta dorëzoj me kërkesën

6.1. Për pjesëmarrjen në Thirrjen publike, aplikanti detyrimisht duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë e plotësuar me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik, e nënshkruar nga personi përgjegjës dhe e vulosur me vulën e aplikantit (kërkesa do të publikohet në faqen e internetit të qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Vendimi për regjistrimin e personit juridik;
- Deklaratë e nënshkruar për shlyerjen e detyrimeve ndaj qytetit të Shkupit (tatimi, taksa komunale);
- Vërtetim që nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedura për thirrje publike, dhënien e kontratave për prokurim publik dhe kontrata për partneritet publiko-private (Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- Propozim projekti i për gatitur me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik;
- Plan financiar i plotësuar me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik.

7. Dokumentacioni shoqërues

7.1. Aplikantët, së bashku me kërkesën, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Biografi profesionale e personelit të kualifikuar që do të angazhohet në realizimin e manifestimit,
- Portofol profesional – një përshkrim i përvojës dhe aftësive organizative,
- Të paktën dy mendime/referenca nga partnerët ose donatorët për realizimin e manifestimevë të mëparshme,
- Mbështetje me shkrim nga organizata ose institucione të tjera që planifikohet të marrin pjesë në realizimin e manifestimit,
- Plan marketingu për manifestimin.

8. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

8.1. Për përcaktimin e përmbushjes së kushteve themelore dhe kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e „Festivalit të Verës - Vinoskop“, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes Publike për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e manifestimit „Festivalit të Verës - Vinoskop“, (Në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

8.2. Aplikimet që janë të dorëzuara me vonesë, ato të parregullta (të palexueshme) ose të paplota dhe nuk i plotësojnë kërkesat dhe kriteret do të refuzohen nga Komisioni me një Konkluzion dhe nuk do të merren në konsideratë, për të cilin do të njoftohen aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

8.3. Për aplikimet që janë të plota, të dorëzuara në kohë dhe që plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni jep propozim deri tek Kryetari e Qytetit për zgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit.

8.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit "Festivali i Verës - Vinoskop".

Vërejtje:

- ***Kërkesat me dokumentacion të paplotë ose që do të dorëzohen pas skadimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Dokumentet e dorëzuara nuk do të kthehen.***
- ***Çdo aplikant mund të dorëzojë vetëm një aplikim për çdo thirrje publike të shpallur.***

9. Afati dhe mënyra e paraqitjes së kërkesave

9.1. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes Publike.

9.2. Kërkesa për me dokumentacion të plotë të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënim - Sektori për zhvillim ekonomik lokal - Aplikim për thirrje publike)

9.3. Aplikantët e thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së Thirrjes Publike.

9.4. Dokumentacioni i plotë, aplikimi për mbështetje financiare, përmbajtja, kushtet, kriteret themelore/veçar ta (si shtojcë në aplikim) dhe plani financiar për propozimin e projektit janë të disponueshme në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për zhvillimin ekonomik lokal, Baraka nr. 6, çdo ditë pune dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk.

9.5. Pyetjet sqaruese mund t'i dërgohen me shkrim ose përmes trajtës elektronike Sektorit për zhvillim ekonomik lokal.

Telefoni kontaktues: (02) 3297-284, adresa e e-mail:
Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk.

QYTETI I SHKUPIT